



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA ADMINISTRATIVE SHKALLA E PARË

V L O R Ë

Nr. 474 Akti  
Datë 28.01.2016

Nr.440 Vendimi  
Datë 31.03.2016

**V E N D I M**  
**"NË EMËR TË REPUBLIKËS"**

Gjykata Administrative e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e përbërë nga:

**GJYQTARE: Gentiana XHELILI**

asistuar prej sekretares gjyqësore Edlira Shehu, sot më datë 31.03.2016 mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore publike, çështjen administrative me nr.474 Akti, që u përket palëve:

**PADITËSE:1-** "PRIFTI-MA"Sh.P.K, me nr-K32809415T NUIS, me seli në Kolonje - Lushnje, Autostrada Fier - Lushnje km 11, me administrator Altin Doko, i biri i Gjystin, i datëlindjes 13.05.1970 lindur dhe banues në lagjen "1 Maj", Fier, identifikuar nga gjykata me kartën e identitetit me nr.H00513021R, përfaqësuar në gjykim me deklaram në seancë gjyqësore nga Av.Durim Bajramaj me nr.3669 license dhe me nr.K96411208N NUIS.

**I PADITUR:1-**Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë, (në mungesë).  
**2-**Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, përfaqësuar në gjykim me autorizimin me nr.3399/1 prot datë 19.02.2016 nga Ervisa Shabani.

**Me pjesëmarrjen në gjykim** të Avokatura e Shtetit Zyra Vendore Vlorë (në mungesë).

**OBJEKTI:1-**Anullimin e gjobes sipas aktit administrativ, njoftim i vleresimit per detyrimin tatimor , nr. 17473 prot, datë 14.10.2015, te nxjerre nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier.

**BAZA LIGJORE:** nenet 4.1, 7, 11, 15, 17, 40 i ligjit nr.49/2012 " Per Organizimin dhe funksionimin e Gjykates Administrative dhe Gjykimin e mosmarreshjeve administrative. Neni 32/a , 154, 106, 202, 324, 325 te K.Pr.Civile, nenet 92, 93, 94, 119, 123, 124 e vijues i K.Civile , nenet 10, 11, 13, 20 te K.Pr.Administrative . Ligji nr.9920, date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republikene Shqiperise", nenet 106, 107, 108, 109, e vijues si dhe udhezimit te Ministrise se Finanacave nr.24 datë 02.09.200.

Gjykata, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, pasi administroi provat shkresore, dëgjoi pretendimet e palës paditëse shoqëria "Prifti-Ma" Sh.P.K, përfaqësuesin e saj av.Durim Bajramaj i cili kërkoi nga gjykata pranimin e kërkesë padisë, dëgjoi palën pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, përfaqësuesin e saj Ervisa Shabani e cila kërkoi nga gjykata rrëzimin e kërkesë padisë, pala e paditur Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë nuk u dëgjua në këtë gjykim dhe nuk ka paraqitur konkluzione përfundimtare me shkrim pranë sekretarisë gjyqësore të kësaj gjykata, pasi ishte në mungesë me gjithë dijeninë e rregullt që kishte për procesin gjyqësor, pala pjesëmarrëse në gjykim Avokatura e Shtetit Zyra Vendore Vlorë nuk u dëgjua në këtë gjykim dhe nuk ka paraqitur konkluzione përfundimtare me shkrim pranë sekretarisë gjyqësore të kësaj gjykata, pasi ishte në mungesë me gjithë dijeninë e rregullt që kishte për procesin gjyqësor dhe si shqyrtoi çështjen në tërësi;

### **V Ë R E N**

Se pala paditëse shoqëria "Prifti-Ma" Sh.P.K i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë me kërkesë padinë me objektin e mësipërm.

Përpara shqyrtimit të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë në prova të kërkesë padisë, gjykata konstatoi se në bazë të neneve 7,10,11 të ligjit nr.49/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*" çështja objekt gjykimi hyn në juridiksionin gjyqësor dhe është në kompetencën lëndore dhe tokësore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

Në bazë të nenit 7 dhe 12 të ligjit nr.49/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", gjykimi u zhvillua me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtarë.

### **Rrethanat e faktit:**

Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi se pala paditëse shoqëria "Prifti-Ma" Sh.P.K ushtron aktivitetin e saj si person juridik me nr-K32809415T NUIS me objekt të veprimtarisë "*Tregtim mallrash industrial, elektrik, material ndërtimi me shumicë e pakicë , etj*" me seli në fshatin Ardenicë Njësia Administrative Kolonjë Lushnje, fakt i cili rezulton nga ekstrakti historik i regjistrit tregtar.

Rezulton se inspektorët e hetimit tatimor të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë kanë ushtruar kontroll në ambientet e shoqëria "Prifti-Ma" Sh.P.K në zbatim të urdhrit me nr.25117 prot datë 27.08.2015 dhe ku në përfundim të kontrollit është mbajtur akt konstatimit me nr.0510232 serie datë 28.08.2015

Nga akt konstatimi me nr.0510232 serie datë 28.08.2015 rezulton se "*subjekti ka të instaluar pajisje fiskale me nr.AE10001615 dhe në momentin e kontrollit nuk e përdorë për shitje që kryhen*".

Nga pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Fier është realizuar akt vlerësimi tatimor me nr.13946 prot datë 19.09.2015 mbi akt konstatimi me nr.0510232 serie datë 28.08.2015 të mbajtur nga inspektorët e hetimit tatimor të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë pranë subjektit shoqërisë "Prifti-Ma" Sh.P.K duke e sanksionuar subjektin me masë administrative me gjobë në vlerën 200.000( dyqind mijë ) lekë.

Në vijim të procedurës nga pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Fier është nxjerrë njoftim vlerësimi për detyrime tatimor me nr.17473 prot

datë 14.10.2015 në vlerën 200.000 (dyqind mijë) lekë në ngarkim të subjektit shoqërisë "Prifti-Ma" Sh.P.K.

Pala paditëse shoqëria "Prifti-Ma" Sh.P.K pasi ka marrë dijeni për njoftim vlerësimin tatimor me nr.17473 prot datë 14.10.2015 të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier ka ushtruar ankim administrativ në datë 28.10.2015 pranë Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë, e cila kjo e fundit me vendimin nr.33348/1 prot date 14.12.2015 ka vendosur "lënien në fuqi të aktit administrative njoftim vlerësimi për detyrime tatimor me nr.17473 prot datë 14.10.2015 të nxjerrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, për gjobën në masën 200.000( dyqind mijë) lekë për mos lëshimin e kuponit tatimor".

**Pala paditëse shoqëria "Prifti-Ma" Sh.P.K duke mos qenë dakort me masën administrative të marrë nga pala e paditur i është drejtuar me kërkesë padi gjykatës duke pretenduar se;**

**Së pari;** Subjetin yne ushtron aktivitetin privat me objekt "Tregti mallrash industriale , elektrike, materiale ndertimi, me shumice dhe pakice , import - eksport", Me dt. 28.08.2015 , sipas akt konstatimit te bere nga hetimi tatimore, prane Drejtorise se pergjithshme Tatimore, eshte ushtruar kontroll ne subjektin e tij, dhe nga ana e tyre eshte pretenduar se nuk eshte prere kuponë nga kasa. Sipas ketij akt konstatimit, nga ana e DRT Fier i eshte bere njoftim i vleresimit per detyrimin tatimor,nr.17473prot datë 14.10.2015.

Kete njoftim vleresimi, brenda afateve ligjore, e kane ankimuar brenda afatit administrativ, prane pales paditur.

**Së dyti;** Akti administrativ, Njoftim Vleresimi Tatimor nr.17473 prot datë 14.10.2015 , per gjoben ne masen 200.000 lekë për mos leshim i kuponit tatimor , nuk qendron per kete arsye kerkon te konstatohet i pavlefshem, duke bere keshtu anulimin e gjobes, ne vleren 200 000 lek, per arsye se procedura eshte e parregullt pasi dhe ne referim te akt konstatimit, rezulton qe nga ana e grupit te kontrollit te jete bere verifikimi i kases dhe nje kopje e kuponit i eshte bashkangjitur ketij akti.

Ne ambjentin e bizensit nuk ka pasur asnje punonjes te shoqerise , as klient, ka qene vetem punonjesi i pastrimit dhe dera e dyqanit ka qene e mbyllur.

Në referim te ligjit te mesipermen nenit 54/3 dhe 55/1 eshte percaktuar detyrimi i tatimpaguesit per perdorimin e sistemit fiskal nepermjet pajisjeve fiskale dhe leshimin e kuponit tatimor per çdo trasaksion , ku citon "Te gjithë tatimpaguesit e shitjeve me pakice qe shesin mallra apo ofrojne sherbime ne mjedise apo njesi te perhershme, te hapura per publikun, duhet te instalojne pajisje fiskale dhe te leshojne kupona tatimor per çdo trasaksion.. Tatim paguesit, qe kryejne qarkullimin e mallrave dhe te sherbimeve, per te cilat pagesat nuk kryhen nepermjet bankes, janë te detyruar te fusin dhe te perdorin sistem fiskal, nepermjet perdorimit te pajisjeve fiskale, per regjistrimin e pagesave me para ne dore dhe leshimin, ne menyre te detyrueshme, te kuponin tatimor.

Po keshtu edhe ne udhezimin nr.24 date 02.09.2008 "Për Procedurat Tatimore ne RSH", kjo dispozite percakton qarte se e detyrueshem kasa eshte per biznesin e vogel i cili nuk kryen veprime me banke.

**Së treti;** ne rastin konkret, biznesi i paditësit eshte i llojit sh.p.k, por edhe pse funksionon si shoqëri, ne respektim te ligjit paditësi është i pajisur edhe me kase edhe pse veprimet i kryhen me fature tvsh, gjithmone paditësi i

ka bashkangjitur edhe kuponin tatimor, çdo fature te leshuar nga ana e shoqërisë, per cdo shifre ose trasaksion.

DPT nuk mund te provoje ne asnje moment shkeljen qe konstaton, nuk ka permendur ne aktin e saj, as klientin qe ka blere mallin, ose ka kryer trasaksionin nga shoqëria, as mallin i cili eshte blere ne dyqanin e paditësit, as ndonje numër ose shenje identifikuesi të mallit i cili është shitur pa kupon tatimor, pra cili është malli qe paditesi ka shitur pa kupon tatimor dhe cila është pala blerese.

Për sa më sipër, pala paditëse shoqëria "Prifti-Ma" Sh.P.K kërkoi nga gjykata pranimin e kërkesë padisë si të bazuar në ligj dhe në prova.

**Palët e paditura, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier nëpërmjet përfaqësueses së saj ka kerkuar rrezimin e kerkeses-padise dukeprapësuar në këtë gjykim se;**

**Së pari;** Nga administrimi i provave te ndodhura pran DRT Fier, rezulton se kerkuesi Shoqeria "Prifti-Ma" shpk, me seli ne Kolonje-Lushnje, autostrada Fier- Lushnje km 11, me NIPT K32809415T me administrator Z. Altin Doko, eshte nje subjekt qe ushtron aktivitet ne fushen e tregtesiseetia me shumice e artikujve te tjere dhe e artikujve te perziere, ne daten 28.08.2015 I eshte ushtruar kontroll nga Inspektoret e Hetimit Tatimore Tirane, date ne te cilen eshte mbajtur dhe Akt Konstatimi me nr. Serial 0510232 dt.28.08.2015, ne te cilin konstatohet se subjekti nuk leshon kupon tatimor. Duke qene se subjekti "Prifti MA", administrohet nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, Drejtoria e Hetimit Tatimor Tirane e ka percjelle Akt Konstatimin e mesiperm per procedura te mëtejshme pranë D.R.T Fier.

Bazuar ne Akt Konstatimin me nr. Serial 0510232 dt.28.08.215, inspektoret e Drejtorise se Vleresimit te Vleresimit te te Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit prane DRT Fier kane mbajtur Akt -Vleresimin me nr.13946 dt. 19.09.2015 per vendosjen e denimit per mosleshim te kuponit tatimor.

Pas kontabilizimit te gjobes per mosleshim te kuponit tatimor Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, penalitetin ne vleren 200.000 leke per mosleshim te kuponit tatimor ja komunikon subjektit "Prifti MA" shpk me "Njoftim Vleresimin per Detyrimet" me nr.17473 datë 4.10.2015.

Me Njoftim Vleresimi nr. 17473 datë 14.10.2015, subjekti "Prifti M A" shpk nuk ka qene dakort dhe per kete arsye e ka ankimuar prane Drejtorise se Apelimit Tatimor ne Tirane, ku Drejtoria e Apelimit Tatimor Tirane pasi e ka marre ne shqyrtim ankimimin e subjektit "Prifti MA" shpk, me shkresen nr.33348/1 dt. 14.12.2015 ka vendosur "*Lenien ne fuqi te Njoftim Vleresimit per Detyrimet me nr.17473 dt.14.10.2015*".

Me pas ne daten 09.02.2016, subjekti "Prifti MA" shpk me NIPT K32809415T i eshte drejtuar gjykates me objekt: "*anullimin e gjobes sipas aktit administrative, Njoftim Vleresimi per Detyrimet Tatimore nr.17473 prot. dt.14.10.2015*"

**Së dyti;** Nga verifikimi i provave materiale te ndodhura prane Drejtorise rajonale Tatimore Fier, rezulton se akti Administrativ Njoftim Vleresim nr. 17473 dt. 14.10.2015 eshte teresisht ligjor, konform formes dhe procedures se kerkuar nga ligji procedural dhe ai material.

Pretendimi i subjektit se akti administrativ eshte i pavlefshem, nuk ka baze ligjore pasi Akt -Konstatim datë 28.08.2015 eshte teresisht konform ligjit, ne akt konstatim thuhet se subjekti ka te instaluar pajisjen fiskale por nuk leshon kupon tatimor, kuponi i cili i eshte bashkelidhur Akt Konstatimit të datës 28.08.2015 eshte marre nga subjekti per te vertetuar se subjekti ka te instaluar paisjen fiskale, provë e cila tregon se subjekti leshon kupon tatimor, eshte gjurma qe ruan paisja fiskale per kuponin e leshuar, i cili ne momentin e printimit per te provuar leshimin e kuponit tatimor, del me shenimin kupon jo tatimor.

Ne zbatim te nenit 54, 55 të ligjit me nr.9920/2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, tatimpaguesi ka detyrimin ligjor per instalimin e paisjeve fiskale dhe leshimin e kuponit tatimor per çdo transaksion i cili nuk paguhet nepermjet bankes.

Në rastet kur subjekti nuk plotëson detyrimin ligjor për lëshim te kuponit tatimor per transaksionet e kryera, vlera e te cilave eshte me e vogel se 150.000, tatimpaguesi penalizohet konform nenit 122 pika b e ligjit nr.9920/2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë".

**Së treti;** pretendimi i subjektit se ka statusin SHPK dhe në baze te ligjit nuk ka detyrimin ligjor per instalim te paisjeve fiskale, nuk qendron pasi ligji nuk shprehet ne lidhje me statusin e tatimpaguesit nese eshte person fizik, apo shpk per instalimin e paisjeve fiskale, ne baze te ligjit nr.9920/2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" (i ndryshuar) dhe te VKM-se nr.781 datë 14.11.2007, (i ndryshuar) te gjithë subjektet pa paerjashtim kane detyrimin ligjor per instalimin e paisjes fiskale dhe per leshimin ne menyre te detyrueshme te kuponit tatimor për transaksionet me vlere me te vogel se 150.000lekë.

Subjekti pretendon se ne subjekt ne momentin e kontrollit dyqani ka qene i mbyllur dhe nuk ka pasur njeri perveç, punonjesit te pastrimit. Nese dyqani do te ishte i mbyllur si e moren kuponin tatimor me nr.2, me vlere zero Inspektoret e Hetimit Tatimor, kupon i cili u mor për të vertetuar instalimin e kases fiskale. Pretendimi se ne momentin e kontrolli nuk eshte bere verifikim i kase, nuk qendron dhe kjo e faktuar me kuponin tatimor nr.2 i cili i eshte bashkelidhur Akt Konstatimit të datës 28.02.2015.

Pretendim i subjektit qe Taks-Forca nuk provon ne aktin e saj as klientin, as mallin e shitur pa kupon nuk ka baze ligjore dhe shkresore, pasi referuar ligjit nuk eshte detyre e inspektoreve te verifikojne mallin qe shitet pasi roli kryesor i tyre eshte te kontrollojne tatimpaguesin ne radhe te pare.

Pretendimet e tij subjekti nuk i ka bazuar as ne ligj dhe as ne prova shkresore, ne asnje moment ne kerkese padi subjekti nuk argumenton se ku konsiston pavlefshmeria e akteve administrative referuar nenit 118 të Kodit të Procedurave Administrative.

Pra subjekti nuk argumenton se perse njoftim vlerësimi me nr.17473 dt.14.10.2015 ka dale ne kundershtrim me ligjin. Kontrolli i ushtruar ne subjektin "PRIFTI MA" eshte ne perputhej me nenin 80 te Ligjit nr.9920/2008 dhe te UMF me nr.24 datë 02.09.2008 "Për Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqiperise" (i ndryshuar).

Njoftim vleresimi nr.17473 datë 14.10.2015 është ne perputhje me nenet 68 dhe 70 te ligjit nr.9920/2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" (i ndryshuar).

Drejtoria Rajonale Tatimore nuk është ne kundërshtim me ligjin ne nxjerrjen e njoftim vlerësimit nr.17473 datë 14.10.2015, pasi ne nenin nr.70 te ligjit "Per Procedurat Tatimore" percaktohet e drejta e Administrates Tatimore per nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor.

**Së katërti;** një fakt tjetër që duhet të jetë në konsideratë nga Gjykata është fakti se padia ka një objekt i cili jo vetëm që nuk legjitimohet që të ngrihet por padia e ngritur nga ana e subjektit "Prifti Ma" sh.p.k është jashtë afatëve ligjore.

Kështu vendimi i Drejtorisë së Apelit Tatimor që ka lënë ne fuqi Njoftim Vleresimin me nr.17473 datë 14.10.2015 është i datës 14.12.2015 dhe ne bazë të nenit nr.23 të ligjit me nr.9920/2008 "Per Procedurat Tatimore ne R.Sh" i ndryshuar, aktet shkresore konsiderohen të marra brenda 10 ditëve nga dorëzimi i tyre ne poste, ne nenin 23 konkretisht percaktohet Neni 23 "Menytrat e komunikimit me tatimpaguesin"; "3. Afati i marrjes dijeni për aktet dhe korrespondencën tjetër, që i dërgohet tatimpaguesit, është dhjetë ditë kalendarike pas datës së dërgimit. Data e dërgimit është data e pranimit të dokumentit nga shërbimi postar. 4. Tatimpaguesi është i detyruar të deklarojë adresën e saktë, në mënyrë që të sigurojë marrjen në kohë të njoftimeve."

Në zbatim të nenit nr.18/19 të ligjit me nr.49/2012 "Per Organizimin dhe Funksiotumin e Gjykatave Administrative dhe Zgjidhjen e Mosmarrveshjeve Administrative" dhe të ligjit nr.9920/2008 "Per Procedurat Tatimore ne R.Sh" i ndryshuar, padia duhet të ngrihet brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni ose nga data që konsiderohte të jetë marre.

Kështu Vendimi i Drejtorisë së Apelit Tatimor është i datës 14.12.2015, në zbatim të ligjislacionit të sipërcituar Akti Administrativ Vendim i Drejtorisë së Apelit Tatimor konsiderohet i marre në datën 24.12.2015 dhe afati maksimal për ngritjen e padisë do të ishte data 24.01.2016 nderkohe që padia është rregjistruar në Gjykatë në datën 09.02.2016, ku nëse do të referoheshim kundërshtimit të vendimit të Drejtorisë së Apelit Tatimor, po në kushtet tona vlen të theksuar se vendimi i Drejtorisë së Apelit Tatimor nr.33348/1 datë 14.12.2015 nuk është kundërshtuar në Gjykatë nga pala paditese shoqëria "Prifti Ma", kjo nënkupton se subjekti është dakort me këtë vendim, i cili ka lënë ne fuqi "Njoftim Vleresimin" nr.17473 datë 14.10.2015, i dalë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier.

Për sa më sipër pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Fier me anë të përfaqësueses së saj ka kërkuar nga gjykata rrëzimin e kërkesës padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova.

**Pala e paditur Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë** nuk u dëgjua në këtë gjykim pasi është vijuar gjykimi në mungesë me gjithë njoftimin e rregullt që kishte për procesin gjyqësor dhe nuk ka depozituar prapësime apo konkluzione përfundimtare me shkrim pranë sekretarisë gjyqësore të kësaj gjykate.

**Pala e pjesëmarrëse ne gjykim Avokatura Shtetit Zyra Vendore Vlorë** nuk u dëgjua në këtë gjykim pasi është vijuar gjykimi në mungesë me gjithë njoftimin e rregullt që kishte për procesin gjyqësor dhe nuk ka depozituar prapësime apo konkluzione përfundimtare me shkrim pranë sekretarisë gjyqësore të kësaj gjykate.

**Gjykata pasi kreu një hetim të plotë dhe të gjithëanshëm çmon se kërkesë padia duhet të pranohet si e bazuar në ligj dhe në prova.**

**Arsyetimi ligjor:**

Në nenin 15 të ligjit nr.49/2012 "Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" parashikohet se "

*Të drejtën e padisë e ka:*

*a) çdo subjekt, që pretendon se i është cënuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik.*

Në nenin 17 të ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative" parashikohet se;

*Padia ngrihet:*

*a) për shfuqizimin tërësisht apo pjesërisht të aktit administrativ;*

Rezulton se pala paditëse shoqëria 'Prifti-Ma' sh.p.k ka një interes legjitim për të kërkuar anulimin e aktit administrativ të njoftim vlerësimi për detyrimet Tatimore nxjerrë nga pala e paditur DRT Fier lene ne fuqi nga Drejtoria e Apelimit Tatimor, pasi nga ky vendim i cënohet interesi pasuror.

Çështja objekt gjykimi rregullohet nga nr.9920 datë 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikë në Shqipërisë" (i ndryshuar).

**Në nenin 54 të ligjit parashikohet se "1. Kuponi tatimor është dokumenti i lëshuar me anë të pajisjeve fiskale apo të pajisjeve të tjera elektronike me aparat shtypshkrimi.**

**2. Subjektet, që detyrohen të lëshojnë kupona tatimorë, mund të lëshojnë njëherazi edhe faturë, nëse shitja apo shërbimi i kryer është për një përdorim tregtar dhe, për këtë shkak, blerësi është i detyruar ta kërkojë faturën.**

**3. Të gjithë tatimpaguesit e shitjeve me pakicë, që shesin mallra apo ofrojnë shërbime në mjedise apo njësi të përhershme, të hapura për publikun, duhet të instalojnë pajisje fiskale dhe të lëshojnë kupona tatimorë për çdo transaksion.**

**4. Kuponi tatimor, i pashoqëruar me faturë, nuk njihet si dokument justifikues i shpenzimeve për blerësin, ushtrues të një veprimtarie tregtare.**

Ne nenin 55 te ligjit parashikohet se '**1. Tatimpaguesit, që kryejnë qarkullimin e mallrave dhe të shërbimeve, për të cilat pagesat nuk kryhen nëpërmjet bankës, janë të detyruar të fusin dhe të përdorin sistemin fiskal, nëpërmjet përdorimit të pajisjeve fiskale, për regjistrimin e pagesave me para në dorë dhe për lëshimin, në mënyrë të detyrueshme, të kuponit tatimor.**

**2. Këshilli i Ministrave miraton karakteristikat teknike e funksionale të pajisjeve fiskale, të sistemit të integruar të kompjuterizuar për transferimet periodike, automatike të deklarimeve financiare, të sistemit të komunikimit, procedurën dhe**

dokumentacionin për miratimin e tyre, kriteret për pajisjen me licencë të shoqërive, që ofrojnë pajisjet fiskale, si dhe kushtet e heqjes së licencës për këto shoqëri.

**3.** Ministri i Financave, me udhëzimin, miraton procedurën dhe dokumentacionin për miratimin për përdorim të pajisjeve fiskale, elementet e kuponit tatimor, mënyrën e kontrollit dhe kontrollin e pajisjes fiskale, distancën e ruajtjes së kuponit tatimor dhe rregullat për mirëmbajtjen e tyre teknike e të shërbimit.

Neni 122 i ligjit parashikon kundravajtjet administrative në përdorimin e pajisjeve fiskale, për lëshimin e kuponave fiskalë e të biletave dhe konkretisht :

**1.** Tatimpaguesi, person juridik ose fizik, tregtar, dënohet në rast se:

a) nuk instalon pajisjen fiskale për regjistrimin e pagesave me para në dorë:

i) herën e parë të konstatimit të mosinstalimit të pajisjes fiskale, për të cilën është përcaktuar një afat vendosjeje deri në 10 ditë pune, me gjobë në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë;

ii) herën e dytë të konstatimit të mosinstalimit të pajisjes fiskale, pas mosrespektimit të afatit të parë 10-ditor dhe kur për këtë pajisje është përcaktuar një afat vendosjeje tjetër deri në 10 ditë, pas vendosjes së gjobës së parë, sipas nëndarjes "i" të shkronjës "a" të kësaj pike, me gjobë në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë;

iii) pas kësaj periudhe, sipas nëndarjes "ii" të shkronjës "a" të kësaj pike, me pezullim të veprimtarisë deri në 6 muaj;

iv) në rastet e mosvendosjes së pajisjes fiskale, me mbyllje të plotë të veprimtarisë;

**b) nuk lëshon kupon tatimor për qarkullimin e realizuar të mallrave apo të shërbimeve, për çdo rast konstatimi:**

i) për kontrollin e parë, me gjobë, në masën 200 000 (dyqind mijë) lekë, për tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin, dhe gjobë, në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë, për tatimpaguesit e tjerë;

ii) për kontrollin e dytë, me gjobë, në masën 300 000 (treqind mijë) lekë, për tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin, dhe gjobë, në masën 200 000 (dyqind mijë) lekë, për tatimpaguesit e tjerë;

iii) për kontrollin e tretë, me gjobë në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë ose me mbyllje të veprimtarisë deri në 6 (gjashtë) muaj;

Gjykata çmon se pala e paditur Drejtoria e Tatimeve Fier ka nxjerre njoftim vleresimin tatimor date 14.10.2015 në kundërshtim me ligjin për keto arsye;

Rezulton se në akt-konstatimin mbajtur në date 28.08.2015 nga grupi i kontrollit ka rezultuar se subjekti është i regjistruar në QKR me NIPTIN perkates, ka të instaluar pajisjen fiksale me nr.perkates dhe në momentin e kontrollit nuk e përdor për shitjet që kryen.Ne punë është gjetur shtetasi Artan Çela , i cili për mallin e gjetur ka paraqitur faturat tatimore të shitjes.Subjekti ka pasur të afishuar listen e çmimeve dhe posterin 'ju lutem terhiqni kuponin tatimor', subjekti ushtron aktivitet në pronësi'.

Nga ky akt -konstatim nuk rezulton qe inspektorët ne momentin e kontrollit të të këne gjetur subjektin duke shitur mallra shërbimi pa leshuar kupon tatimor. Prapesimi i pales se paditur se kuponi tatimor i prere nga inspektorët per te provuar se pajisja fiskale punon ka pasur numrin serial 2, fakt qe tregon se subjekti gjate 12 viteve ka leshuar vetem nje kupon tatimor duke mos permbushur detyrimin ligjor per leshim kuponi tatimor nuk qendron.

Ne Udhëzimin nr.16, date 3.5.2010 "Për administrimin dhe dokumentimin e procedurave të pajisjeve fiskale parashikohen elementet qe duhet te permbaje nje kupon tatimor dhe konkretisht ;

#### *2.1 Logo fiskale, forma*

*Logo fiskale është shenja identifikuese që vendoset në çdo kupon tatimor që certifikon dhe regjistron shitjet në memorien fiskale dhe në qarkun e shiritit të kontrollit. Logo fiskale vendoset në të gjitha raportet tatimore ditore.*

*Logo fiskale është e përbërë nga dy rreshta:*

- 1. Në rreshtin e parë shkruhet RSH (Republika e Shqipërisë);*
- 2. Në rreshtin e dytë shkruhet MF (Ministria e Financave). Në lartësinë e dy rreshtave të logos përpara RSH dhe MF duhet të jetë stema e republikës në variantin bardhë e zi: Forma grafike e logos fiskale: 1. Fjalët RSH dhe MF duhet të jenë:*
- 2. Fonti - Arial;*
- 3. Formatit - Bold;*
- 4. Madhësia e shkrimit e njëjtë me madhësinë e shkrimit të elementeve të tjera të;*
- 5. Kuponit tatimor;*
- 6. Lartësia e siglës së Republikës e barabartë me lartësinë e dy rreshtave të fjalëve RSH*
- 7. dhe MF*
- 8. Logo fiskale vendoset në fund të kuponit i pozicionuar në qendër.*

Ne pikën 2.2 të këtij Udhëzimi përcaktohen edhe të dhënat e kuponit tatimor dhe prezantimi grafik i tij dhe konkretisht ;

*Kuponi tatimor që i jepet një blerësi apo një klienti, përmban të dhënat e mëposhtme:*

#### *2.2.1 Koka e kuponit:*

- a) Emrin, adresën e tatimpaguesit;*
- b) NIPT-in;*

#### *2.2.2 Detajet e kuponit tatimor:*

- c) Emrin, sasinë, çmimin dhe vlerën e qarkullimit të regjistruar të mallrave dhe/ose të shërbimeve;*
- d) Totale e vlerës së mallrave apo shërbimeve të shitura;*
- e) Mënyrën e pagesës (cash, çek, kartë krediti etj.);*
- f) Shumën e TVSH-së, sipas shkallës tatimore;*
- 2.2.3 Këmba e kuponit tatimor:*
- g) Numrin e identifikimit të pajisjes fiskale;*
- h) Numri i pajisjes ( identifikon numrin në rrjet për një supermarket), emrin ose kodin e operatorit;*
- i) Datën dhe orën e lëshimit të kuponit;*
- j) Logon fiskale;*
- k) Numrin e kuponit.***

Numri i identifikimit dhe logo fiskale janë shenjat dalluese që kuponi më sipër është KUPON TATIMOR.

Kuptimi i tyre është: Kuponi numër 20 (**numër rendor pas mbylljes tatimore ditore**) është kupon tatimor, pasi është lëshuar nga pajisja fiskale me numër identifikimi "XXXXXXXXXX" dhe i instaluar në Republikën e Shqipërisë me autorizim të Ministrisë së Financave. Çdo kupon që nuk përmban këto shenja dalluese nuk është i natyrës tatimore.

**Pas printimit të raportit tatimor ditore numërori i Kuponeve Tatimore dhe i kuponeve jo tatimore që janë lëshuar gjatë ditës zerohen.**

Nga ky parashikim ligjor, rezulton se numri rendor i kuponit tregon se brenda periudhes 24 ore (1 dite) janë prera aq kupona tatimor sa tregon pajisja dhe jo sa kupona tatimore janë prera që nga fillimi i funksionimit të kases fiskale.

Vetem fakti se kuponi tatimor prere nga inspektorët tatimore tregonte numrin 2 nuk mund të përbejë arsye ligjore që subjekti të denohet administrativisht me gjobe për mos lëshim kuponi tatimor pasi nga inspektorët tatimore duhet të konstatohej se subjekti kryente shitje pa prere kupon tatimor dhe pas konstatimit të vendoste denimin administrativ .

Është detyrim i organit publik që të provojë në mënyrë të plotë dhe të sakte se tatimpaguesi ka shkelur ligjin "Per procedurat tatimore".

Pala e paditur gjatë gjykimit nuk ka provuar dhe ishte barra e saj provuese që të provonte se subjekti në momentin e kontrollit ka kryer shitje pa prere kupon tatimor në kundërshtim me ligjin 'Per procedurat tatimore'.

Bazuar në nenin 35 të ligjit nr.49/2012 'Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative' **organi publik ka detyrimin të provojë ligjshmerine e aktit administrativ dhe të veprimit tjetër administrativ, të nxjerrë jo me kërkesë të paditesit , si dhe faktet që ai ka parashtruar dhe ka vënë në themel të veprimtarisë së kundërshtuar në gjykatë.**

Sa më sipër, gjykata çmon se njoftim-vlerësimi për detyrimet tatimore Nr.17473 prot, datë 14.10.2015 i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Fier duhet të shfuqizohet si akt administrativ i nxjerrë në kundërshtim me ligjin.

Prapësisht i palës së paditur se pala paditëse e ka paraqitur padinë në gjykatë jashtë afatit ligjor është i pabazuar në ligj dhe në prova pasi rezulton se vendimi me nr. 33348/1 prot, datë 14.12.2015 i Drejtorisë së Apelit Tatimor i është komunikuar vetë palës së paditur Drejtorisë së tatimeve Fier në datë 30.12.2015 vertetur nga numri i protokollit në këtë vendim 17473/2 .

Pala e paditur nuk mund të pretendojë se në rastin e këtij vendimi zbatohet neni 23 i ligjit 'Per procedurat tatimore në RSH' i cili parashikon se "afati i marrjes dijeni për aktet dhe korrespondencën tjetër që i dërgohet tatimpaguesit është 10 ditë kalendarike pas dates së dërgimit.Data e dërgimit është data e pranimit të dokumentit nga shërbimi postar" pasi nuk provohet se data e dërgimit postar është datë 14.12.2015, por provohet se vetë pala e paditur DRT Fier ka marrë dijeni epr këtë vendim në datë 30.12.2015 dhe afati për paraqitjen e padisë në gjykatë fillon nga dita e nesërme e marrjes dijeni pra nga

data 31.12.2015 dhe rezultoi se pala paditese e ka paraqitur padine ne gjykate ne daten 28.01.2016, pra brenda 30 diteve ashtu siç parashikohet edhe ne ligjin 'Per procedurat tatimore'.

Sa më sipër gjykata vendos pranimin e kërkesë padisë të paraqitur nga pala paditëse shoqëria "Prifti-Ma" Sh.P.K me objekt'shfuqizimin e aktit administrative Njoftim-Vlerësimi për detyrimet Tatimore me nr.17473 prot datë 14.10.2015 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier' si të bazuar në ligj dhe në prova.

Në zbatim të nenit 106 të K.Pr.civile, shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata bazuar në nenin 40 dhe 41 të ligjit me nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", nenet 306-310 të Kodit të Procedurës Civile

### V E N D O S I

1. Pranimin e kërkesë padisë.
2. Shfuqizimin e aktit administrativ, Njoftim-Vlerësimi për detyrimet Tatimore me nr.17473 prot datë 14.10.2015 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier.
3. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.  
Kundër këtij vendimi nuk parashikohet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

U shpall në Vlorë, sot më date 31.03.2016

**SEKRETARË**

Edlira SHEHU

**SHPENZIMET GJYQËSORE**

Taksa e rregjistrimit  
TOTALI

3.000 (tre mijë) lekë.

3.000 (tre mijë) lekë.

**GJYQTARË**

Gentiana XHELILI

